



Bazuar në Ligjin e AKP-së Nr.04/L-034 si dhe Nenet 8 dhe 10 të Ligjit të Punës Nr. 03/L – 212, Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall konkurs për:

**DREJTOR MENAXHUES i Ndërmarrjes Shoqërore Inex Sharr Planina Brezovicë
(1 Pozitë) / nr. i referencës 01/2022**

Personi që përzgjidhet për Drejtor Menaxhues të NSH “Inex Sharr Planina” në Brezovicë ndër të tjera duhet të ketë:

- Diplomë të nivelit universitar në ekonomi, financa, administrim biznesi, menaxhim, juridik apo përgatitje tjetër përkatëse. Diploma post diplomike e nivelit Master është përparësi;
- Të paktën 5 vite përvojë pune përkatëse profesionale në sektorin privat apo publik duke përfshirë 3 vite përvojë pune në pozita udhëheqëse;
- Aftësi për të marrë vendime të vështira, nën presion dhe në përgjithësi të ketë aftësi dhe përvojë për të punuar në ambient të proceseve të ndërlikuara dhe aftësi të orientohej kah rezultatet;
- Aftësi të shkëlqyeshme udhëheqëse, organizative, komunikimi dhe aftësi negocimi;
- Aftësi për të motivuar dhe mobilizuar personelin lidhur me misionin dhe qëllimet e ndërmarrjes;
- Të ketë integriteti të lartë moral dhe t’i përmbahet standardeve të larta të etikës;
- Aftësi të shkëlqyeshme ndër personale dhe aftësi në zgjidhjen e konflikteve;
- Njohuri të rrjedhshme në të folur dhe në të shkruar në gjuhët shqipe dhe serbe, njohja e gjuhës angleze është përparësi.
- Aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një mjedis multietnik dhe multikulturor;
- Njohuri të shkëlqyeshme në aplikacionet e Microsoft Office.

Afati për paraqitjen e dokumentacionit është 15 ditë nga data **18.08.2022 deri me datën 01.09.2022 ora 16:00.**

Përshkrimi i detajuar i vendit të punës do të publikohet në ueb-faqen: www.pak-ks.org

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

Aplikacioni i punësimit ose CV;
Letër Motivuese;
Dëshmi të kualifikimeve shkollore;
Dëshmi mbi përvojën e punës;
Certifikatën që nuk jeni nën hetime;
Dokumentin e identifikimit të lëshuar nga MPB e Republikës së Kosovës.

Dokumentet e kërkuara më lartë i dërgoni në e-mail adresën: rekrutimi@pak-ks.org

Titulli i e-mailit tuaj duhet të përmbajë pozitën dhe numrin e referencës për të cilën ju aplikoni.

“Agjencia Kosovare e Privatizimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”

“Komuniteti jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e administratës publike qendrore dhe lokale”.

Dokumentet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar do të refuzohet.

Ne i falënderojmë të gjithë kandidatët për aplikim, por vetëm kandidatët në listën e ngushtë do të kontaktohen.